

Ka qene nje pune a madhe dhe e dedikueshme nga themeluesit e Shoqates MEDPAK te nderuarit zotit Nazmi e zonjes ZELA KOKA qe ben te mundur krijimin dhe zgjerimin a kesaj Shoqate .

Duke filluar me projektin Mencap ne vitin 1995, nje bashkpunim i Expats, sebashku me zonjat Val WEBSTER, Ann NORRIS, Jackie HAYES beri te mundur aktivitete dhe trainime ne bashkpunim te ngushte me Shoqaten e Librazhdit.

Ne vitin 1996, nje sukses i madh per Shoqaten e komunitetin e familjeve me njerez me aftesi te kufizuara, ishte zhvillimi i Trainimit te anetareve te ketij komuniteti. Si dhe ndergjegjesimi i pushtetit Lokal per kete komunitet .



Puna e dedikueshme e familjes KOKA per Organizimin dhe Realizimin e ketij Projekti ka qene e admirueshme dhe nje nder arritjet me te mira ne Shqiperi .

Me admirim dhe respekt dhe frymezim per shume Shoqata te tjera ne gjithe Shqiperine .

Zonje Ann NORRIS nje nder sponsorat me te dedikuar te kesaj Shoqate ka pasur si bosht frymezimi Zotin Nazmi e Zela KOKA . Te cilet i treguan frymen a ngrohete te zemres e mikprijen Shqiptetare .

Ne takimet tona ne Angli kur ne mblidhemi, gjithmone Ann, Jackie dhe une kujtojmë me nostalgji arritjet por dhe veshtiresit qe mund te haseshin ndonjehere ne Shqiperi.

Me keqardhje degjuam ndarjen nga jeta jone te nderuait te ndjerit Nazmi KOKA i cili ka qene nje njeri me karakter dhe virtyta te larta . Me qetesine qe e karakterizonte e urtesine e tij, Zoti Nazmi kishte nje vizion te qarte e te prere per te ardhmen e komunitetit.

Zonja Zela, perkrah zotit Nazmi, ka bere nje pune te mrekullueshme per komunitetin, edhe duke aktivizuar djalin e tyre Doris, i cili tregoi se mund te punesohej dhe te kishte pergjegjesi per te kryer projekte te ndryshme por dhe te mund te ishte i pavarur.

Ne ju urojme gjithe komunitetit te Shoqates MEDPAK Librazhd: Sukses ne rrugen qe kane marre dhe mbaresi .

**Me respekt dhe dashuri**

**i juaji**

**Agim, Klodjana dhe vajzat**